



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E APELIT  
VLORE

NR. 2303/1282/736 i Rregjistrimit  
DT.18.06.2018 i Rregjistrimit

Nr. 116 i vendimit  
Dt. 26.02.2019 e VENDIMIT

V E N D I M  
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Apelit Vlore, e përbërë nga gjyqtarët:

Margarita Buhali - Kryesuese  
Skender Damini - Anëtare  
Petrit Aliaj - Anetar

asistuar nga sekretarja gjyqësore [REDACTED] më datat 06.02.2020 dhe 26.02.2020 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me nr.2303/1282/736 rregjistri, me datë 18.06.2018 rregjistrimi, që i përket:

**Paditës:** [REDACTED] i biri i [REDACTED] dhe i [REDACTED] datëlindjes [REDACTED] lindur dhe banues në [REDACTED] përfaqësuar nga av. [REDACTED], anëtar i dhomës së avokatisë [REDACTED]

**I paditur :** Shoqeria Tregtare "AlbpetrolP", sh.a, Patos, - në mungesë.

**Person i tretë:** Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi, Tirane- në mungesë.

Me pjesëmarrjen e zyrës vendore të avokaturës së shtetit Vlorë – në mungesë.

**Objekti:** Konstatimin e faktit të diskriminimit të paditesit ,per shkak te bindjeve politike dhe mosbindjeve te urdharave te kundraligjshem te punedhenesit ne formen e viktimizimit te kryer nga ana e punedhenesit Albpetrol Sha. ,Patos  
Ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave te ardhura duke detyruar punedhenesin "Albpetrol", sh.a , Patos , të rikthej paditesin ne vendin e meparshem te punes ne pozicionin e kryeinxhinierit ose ne nje pozicion pune te barasvlershem me të .

3. Detyrimin e palës së paditur "Albpetrol", sh.a , Patos, të demshperbleje paditesin per demin pasuror dhe jopasuror te pesuar.
- 4- Detyrimin e palës së paditur te pagujae shpenzimet gjyqesore dhe ato te perfaqesimit me avokat.

**Baza ligjore:** Nenet 17/2,18,33/1 dhe 49 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise ,neni 14 i Konventes Europiane të të Drejtave te Njeriut ,nenet 31,32/a,153,154 te Kodit te Procedures Civile , nenet 9,10,10/1 te Kodit te Punes vijues te K.P.C, nenet 3,7,12,13,34,36,37,38 te ligjit nr.10221,dt.04.02.1010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" si dhe nenet 608, 625, 640, të Kodit Civil , Vendimi Unifikues nr.12 datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ,Vendimi i Gjykares Kushtetuese nr.6,dt. 17.02.2012.

**Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier me vendimin nr. 62-2018-2188 ( 573 ) dt. 25.04.2018 ka vendosur si vijon:**

1. Pranimin e pjeshem te padisë.
2. Konstatimin e faktit te diskriminimit të paditesit, [REDAKTUAR] per shkak te bindjeve politike dhe mosbindjeve te urdherave te kundraligjshem te punedhenesit ne formen e viktimizimit te kryer nga ana e punedhenesit ,'Albpetrol" Sha., Patos.
3. Rrezimin e kerkimit te paditesit [REDAKTUAR] , per ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave te ardhura duke detyruar punedhenesin "Albpetrol", sh.a , Patos , të rikthej paditesin ne vendin e meparshem te punes ne pozicionin e kryeinxhinierit ose ne nje pozicion pune te barasvlershem me të, si te pabazuar ne ligj .
4. Detyrimin e palës së paditur Tregetare "Albpetrol", sh.a , Patos , ti paguajë paditesit [REDAKTUAR] shumen e vleres se demit pasuror dhe jo-pasuror në masën 4,098,981 (kater milion e nentedhjete e tete mije e nenteqind e tetedhjete e nje mije ) lekë:
5. Shpenzimet gjyqësore per pjesen e pranuar te padise në ngarkim të palës së paditur.
6. Ky vendim perben titull ekzekutiv dhe bashkëlidhur me këtë vendim lëshohet urdhri i ekzekutimit sipas dispozitivit te ketij vendimi sipas nenit 511/a dhe 515/b te Kodit te Procedures Civile.

**Kunder ketij vendimi ka bere ankim paditesi, I cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plotë të padisë për këto shkaqe;**

1-Pala e paditur e ka transferuar në mënyrë të padrejtë paditesin në kushtet e diskriminimit nga kryeinxhinier në rojë dhe më pas e ka pushuar nga puna.

- 2-Nga librezja e punës provohet se paditësi ka mbajtur detyra të ndryshme në pozicione drejtuese në shoqëri deri dhe deputet në parlamentin e Shqipërisë. Ndërsa në Dhjetor 2015 është pushuar nga puna.
- 3-Në vitin 2014 i padiuri ka kërkuar ta transferojë si roje dhe pas këmbënguljes së paditësit u ndryshua duke u vendosur kalimi në kryeinxhinier. Më pas nga drejtues teknik në QFM Patos është transferuar si inxhinier i thjeshtë sektori në QPN Ballsh. Këto ndryshime janë bërë në mënyrë të njëanëshme pasi është ulur paga dhe as i ishte mbyllur vendi i punës.
- 4-Trajtimi i diferencuar dhe diskriminues i paditësit ka ardhur për shkak të bindeve të tij politike dhe angazhimit të tij me forcën politike Partia Demokratike.
- 5-Me vendimin e datës 30.06.2014 i padituri e ka përfshirë atë me cilësinë e kryetarit në komisionin e kolaudimit të blerjes së 3 autoboteve, ndërkohë që nuk kishte asnjë specialist dhe paditësi nuk kishte asnjë lidhje me këtë komision pasi ishte specialist naftë. Më në fund me vendimin e datës 21.10.2014 ai ishte larguar nga ky komision. Pra paditësi nuk ka pranuar të jetë anëtar për shkak të mungesës së specializimit dhe të faktit që kishte probleme në blerje me cmim dy herë më të lartë se vlera e zakonshme.
- 6-Pas këtij komisioni është bërë dhe transferimi i tij në Ballsh e më pas është pushuar nga puna.
- 7-Pas ankimit të paditësit KMD Tiranë ka konstatuar faktin e diskriminimit me vendimin nr.66 dt.10.08.2017 për shkak të bindeje politike duke urdhëruar të paditurin të merrte maas për rikthimin e tij në punë . Ky vendim u la në fuqi edhe nga gjykata administrative e cila me vendimin nr.80-2016-4546 dt.16.11.2017 rrëzoi padinë e albetrolit.
- 8-Dëmshpërblimi në rastet e diskriminimit ka si synim të ndreqë shkeljet ligjore dhe pasojat e tyre përmes kthimit në gjëndjen e mëparëshme, kompensimin e dukur për dëmet pasurore dhe jopasurore ose përmes masave të tjera të përshtatshme. Këto qëndrime janë mbajtur disa qëndrime nga gjykatat administrative, civile, doktrina juridike.
- 9-Fakti i paligjshëm i kryer nga i padituri ka sjellë pasojat në pakësimin e interesave pasurore e jopasurore të paditësit, gjithë familjes së tij. Cilësinë së jetës, paprekshmërisë së familjes, dhimbjes shpirtërore, cënim personalitetit, pakësimi i të ardhura familjare në mënyrë drastike në mënyrë drastike, cënimin e të drejtës për tu punësuar sipas moshës së paditësit.
- 10-Në rastin konkret plotësohen kushtet për dëmin jashtëkontraktor të parashikuara nga neni 608 e vijues të K.Civil. Lidhur me llojet e dëmshpërblimeve janë të parashikuara nga neni 640 e K.Civil dhe vendimin unifikues nr.12/2007 ku përfshihen dëmi moral, ekzistencial. Për këtë u mor edhe eksperti përkatës për të përcaktuar vlerën e dëmeve të pësuar nga paditësi.
- 11-Në pikën 2 të padisë paditësi ka kërkuar rikthimin në vendin e mëparëshëm të punës, e drejtë e cila ridhte nga vendimi nr.66 dt. 10.08.2017 i KMD. Duke qënë se ai u la në fuqi nga gjykata administrative gjë që e ka shndërruar atë në titull ekzekutimi.

12-Nga akti i ekspertimit psikologjik rezultoi se paditësi kishte pësuar trauma e crregullime psikike që kanë ndikuar negativisht në cilësinë e jetës së tij . Ai ka dëmtime shëndetsore si depresion reaktiv të zgjatur hipertension duke i sjellë dëmtime në punë në masën 25 %. Dhe vlera e dëmit për të gjitha figurat ishte në masën 4877447 lekë.

13-Prandaj vendimi duhet të ndryshohet duke u pranuar padia tërësisht si për kthimin në punë dhe në masën e dëmshpërblimit.

**Kundër vendimit ka bërë ankim i padituri i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë pasi:**

- 1- Paditësi, z. [REDAKTUAR] ka qene punonjes prane Q.F.M.T. Patos dhe me shkresen me nr.8583prot date 12,11.2014 eshte transferuar ne Q.A.R Patos me pozicion pune Inxhinier Nafte ne Zonen e Pare sektori i Dyte.Nga 16 janar 2015 deri ne 01 12.2015 ka qene ne pozicion pune Inxhinier nafte ne QPN Ballsh.Per shkak te mungesave ne pune Z.[REDAKTUAR] I eshte bere zgjidhje e marredhenieve te punes.
- 2- Albpetrol sh.a ka ndjekur dhe respektuar te gjitha procedurat ligjore percaktuar ne Kodin e Punes.Konkretisht ka njoftuar punemarresin me shkresen me nr.6414prot 16.11.2015 se duhej te paraqitej prane Albpetrol sh.a., Drejtoria e Burimeve Njerezore ne date 23.11.2015 ora 10:00 per te diskutuar mbi vazhdimesine e marredhenieve te punes.. Ne takim punemarresi edhe pse kishte dijeni nuk eshte paraqitur.Me pas ka dal vendmi I Administratorit te Albpetrol sh.a per zgjidhjen e marresdhenieve te punes konkretisht vendimi me nr.577 date 02.11.2015
- 3- Gjykata se Rrethit Gjyqesor Fier ne Vendimit Nr.343 date 23.03.2016 vendosi pranimin pjesisht te padise se paditesit [REDAKTUAR] Albpetrol sh.a ka bere ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore dhe gjykata me vendimin me nr.1078 date 18.10.2016 ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit nr. 343 date 23.03.2016 te Gjykares se Shkalles se Pare Fier.
- 4- Persa i perket pretendimit te pales paditese per konstatimin e faktit te diskriminimit per shkak te bindjes se tij politike sqarojme gjykatën se nga ana e punedhenesit nuk eshte zgjidhur marredhenie pune per shkak te bindje politike, pretendim qe nuk gjen mbeshtetje pasi pushtetet jane ndryshuar ne vitin 2013 nderkohe qe marredhenia e pënes eshte zgjidhur ne dhjetor 2015 dhe kjo per shka te mungesave dhe jo per ndonje shkak nga ana e punedhenesit.
- 5- Ne lidhje me me transferimet e paditesit ne qendra te ndryshme ne varesi te Albpetrol sh.a., sqarojme se keto transferime jane bere konform rregullave dhe per nevoja te punes. Ne lidhje me pretendimin e paditesit qe vendosej ne komisione kolaudimi qellimisht dhe ne komisione qe nuk kishin lidhje me njohurite e tij, sqarojme se paditesi zoteron dy diploma (inxhinier dhe jurist) cka ka qene me njohurite e nevojshme per tu vendosur ne komisione.Gjithsesi per vendosjen ne komisione paditesi eshte zevendesuar dhe jo larguar nga puna pasi ka paraqitur kerkese prane administratorit.

- 6- Komisioni per Mbrojtjen nga Diskriminimi, pas hetimit te kësaj çështjeje me date 10.08.2017, ka konstatuar se pretendimet e z.Ylli Shanaj kane qene te bazuara dhe per kete arsye ka vendosur si perfundim "Rikthimin e tij ne pozicionin e meparshem te punes."Konstatimi i diskriminimit te drejteperdrejte te Z. [REDACTED] per shkak te bindjeve politike. Kete vendim Komisioni per Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka bazuar ne nenin I te ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
- 7- Albpetrol sh.a. nuk ka qene dakort me aktin administrativ "vendim" nr.66 date 10.08.2017 te Komisionerit per Mbrojtjen nga diskriminimi dhe e ka kundërshtuar ne gjykate per arsye se: Ky vendim i Komisionit per Mbrojtjen nga Diskriminimi eshte i pabazuar ne ligj dhe ne prova. Ne rastin konkret kjo kontrate pune eshte zgjidhur per shkaqe te justifikuara nga ana e shoqerise Albpetrol sh.a. Patos. Pra nga ana e punedhenesit ekziston nje shkak i arsyeshem per zgjidhjen e marredhenies se punes duke respektuar procedure parashikuar ne Kodin e Punes.
- 8- Neni 608 i K.Civil parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë.Pra i takon pala paditese Albpetrol sh.a qe ka kryer veprime te paligjshme dhe me faj.
- 9- Shoqeria Albpetrol sh.a. Patos nuk ka kryer asnje veprim/mosveprim ne shkaktimin e demtimit te [REDACTED].Shoqeria ka kryer pushimin e tij ne perputhje me Kodin e Punes. Nese shkeputja e marredhenieve te punes eshte e drejte apo jo, kete e vendos gjykata,ashtu sic ka bere edhe ne rastin konkret me vendimin, Nr.343 date 23.03.2016 te Gjykates se Shkalles se Pare Fier lene ne fuqi me vendimin me nr.1078 date 18.10.2016 nga Gjykata e Apelit Vlore duke parashikuar edhe sanksionet perkatese.
- 10- Nga ana e pales paditese nuk eshte provuar te ekzistojte ndonje lidhje shkakësore me pasojen e ardhur.Nga ana e saj nuk u paraqit asnje prove shkresore per te provuar kete fakt.
- 11- Ne rastin konkret nuk u provua se eshte kryer veprim apo mos veprim i paligjshem,nuk eshte shkakuar dem,nuk u provua lidhja shkakësore midis demit qe nuk eshte vertetuar nga pala paditese dhe fajit si element i domosdoshem i pergjegjesise jashte kontraktore.
- 12- Eksperti z. [REDACTED] ka bërë aktin e ekspertimit psikologjik. Akti eshte kundërshtuar nga ana e Albpetrol sh.a per shkak se nuk kishte argumenta provuese te lidhjes shkak - pasoje ne kuptimin qe te eliminonte te gjitha shkaqet e tjera keto dy vite dhe te sillte argument

bindese se i vetmi stres qe paditesi ka pasur dhe ka ishte largimi nga puna.

- 13- Akti I ekspertimit ishte bazuar ne vleresimin psikologjik I cili nuk kishte argument provuese te lidhjes shkak pasoje. Gjithashtu per heqje te pa drejte nga puna paditesi demshperbyer me vendim gjykate.

**Kundër vendimit ka bërë ankim Zyra vendosure e avokaturës së shtetit Vlorë e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë pasi;**

- 1- Paditësi, z. [REDAKTUAR] ka qene punonjes prane Q.F.M.T. Patos dhe me shkresen me nr.8583prot date 12.11.2014 eshte transferuar ne Q.A.R Patos me pozicion pune Inxhinier Naftë ne Zonen e Pare sektori i Dyte.Nga 16 janar 2015 deri ne 01 12.2015 ka qene ne pozicion pune Inxhinier naftë ne QPN Ballsh.Per shkak te mungesave ne pune Z.[REDAKTUAR] I eshte bere zgjidhje e marredhenieve te punes.
- 2- Albpetrol sh.a ka ndjekur dhe respektuar te gjitha procedurat ligjore percaktuar ne Kodin e Punes.Konkretisht ka njoftuar punemarresin me shkresen me nr.6414prot 16.11.2015 se duhej te paraqitej prane Albpetrol sh.a., Drejtoria e Burimeve Njerezore ne date 23.11.2015 ora 10:00 per te diskutuar mbi vazhdimesine e marredhenieve te punes.. Ne takim punemarresi edhe pse kishte dijeni nuk eshte paraqitur.Me pas ka dal vendmi I Administratorit te Albpetrol sh.a per zgjidhjen e marredhenieve te punes konkretisht vendimi me nr.577 date 02.11.2015
- 3- Gjykata se Rrethit Gjyqesor Fier ne Vendimit Nr.343 date 23.03.2016 vendosi pranimin pjesisht te padise se paditesit [REDAKTUAR]. Albpetrol sh.a ka bere ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore dhe gjykata me vendimin me nr.1078 date 18.10.2016 ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit nr. 343 date 23.03.2016 te Gjykates se Shkalles se Pare Fier.
- 4- Persa i perket pretendimit te pales paditese per konstatimin e faktit te diskriminimit per shkak te bindjes se tij politike sqarojme gjykatën se nga ana e punedhenesit nuk eshte zgjidhur marredhenie pune per shkak te bindje politike, pretendim qe nuk gjen mbeshtetje pasi pushtetet jane ndryshuar ne vitin 2013 nderkohe qe marredhenia e pënes eshte zgjidhur ne dhjetor 2015 dhe kjo per shka te mungesave dhe jo per ndonje shkak nga ana e punedhenesit.
- 5- Ne lidhje me me transferimet e paditesit ne qendra te ndryshme ne varesi te Albpetrol sh.a., sqarojme se keto transferime jane bere konform rregullave dhe per nevoja te punes. Ne lidhje me pretendimin e paditesit qe vendosej ne komisione kolaudimi qellimisht dhe ne komisione qe nuk kishin lidhje me njohurite e tij, sqarojme se paditesi zoteron dy diploma (inxhinier dhe jurist) cka ka qene me njohurite e nevojshme per tu vendosur ne komisione.Gjithsesi per vendosjen ne komisione paditesi eshte zevendesuar dhe jo larguar nga puna pasi ka paraqitur kerkese prane administratorit.

- 6- Komisioni per Mbrojtjen nga Diskriminimi, pas hetimit te kësaj çështjeje me date 10.08.2017, ka konstatuar se pretendimet e z.Ylli Shanaj kane qene te bazuara dhe per kete arsye ka vendosur si perfundim "Rikthimin e tij ne pozicionin e meparshem te punes."Konstatimi i diskriminimit te drejteperdrejte te Z. [REDACTED] per shkak te bindjeve politike. Kete vendim Komisioni per Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka bazuar ne nenin I te ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
- 7- Albpetrol sh.a. nuk ka qene dakort me aktin administrativ "vendim" nr.66 date 10.08.2017 te Komisionerit per Mbrojtjen nga diskriminimi dhe e ka kundërshtuar ne gjykate per arsye se: Ky vendim i Komisionit per Mbrojtjen nga Diskriminimi eshte i pabazuar ne ligj dhe ne prova. Ne rastin konkret kjo kontrate pune eshte zgjidhur per shkaqe te justifikuara nga ana e shoqerise Albpetrol sh.a. Patos. Pra nga ana e punedhenesit ekziston nje shkak i arsyeshem per zgjidhjen e marredhenies se punes duke respektuar procedure parashikuar ne Kodin e Punes.
- 8- Neni 608 i K.Civil parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë.Pra i takon pala paditese Albpetrol sh.a qe ka kryer veprime te paligjshme dhe me faj.
- 9- Shoqeria Albpetrol sh.a. Patos nuk ka kryer asnje veprim/mosveprim ne shkaktimin e demtimit te [REDACTED].Shoqeria ka kryer pushimin e tij ne perputhje me Kodin e Punes. Nese shkeputja e marredhenieve te punes eshte e drejte apo jo, kete e vendos gjykata,ashtu sic ka bere edhe ne rastin konkret me vendimin, Nr.343 date 23.03.2016 te Gjykates se Shkalles se Pare Fier lene ne fuqi me vendimin me nr.1078 date 18.10.2016 nga Gjykata e Apelit Vlore duke parashikuar edhe sanksionet perkatese.
- 10- Nga ana e pales paditese nuk eshte provuar te ekzistojte ndonje lidhje shkakësore me pasojen e ardhur.Nga ana e saj nuk u paraqit asnje prove shkresore per te provuar kete fakt.
- 11- Ne rastin konkret nuk u provua se eshte kryer veprim apo mos veprim i paligjshem,nuk eshte shkaktuar dem,nuk u provua lidhja shkakësore midis demit qe nuk eshte vertetuar nga pala paditese dhe fajit si element i domosdoshem i pergjegjesise jashte kontraktore.
- 12- Eksperti z. [REDACTED] ka bërë aktin e ekspertimit psikologjik. Akti eshte kundërshtuar nga ana e Albpetrol sh.a per shkak se nuk kishte argumenta provuese te lidhjes shkak - pasoje ne kuptimin qe te eliminonte te gjitha shkaqet e tjera keto dy vite dhe te sillte argument

bindese se i vetmi stres qe paditesi ka pasur dhe ka ishte largimi nga puna.

- 13- Akti I ekspertimit ishte bazuar ne vleresimin psikologjik I cili nuk kishte argument provuese te lidhjes shkak pasoje. Gjithashtu per heqje te pa drejte nga puna paditesi demshperbyer me vendim gjykate.

## GJYKATA E APELIT VLORE

Pasi degjoi relatimin e çeshtjes nga gjyqtarja Margarita Buhali, shqyrtoi e bisedoi çeshtjen ne teresi në mungesë të të paditurit, të personit të tretë, të zyrës vendore të avokaturës së shtetit Vlorë, dëgjoji pretendimet e paditësit që kërkoi *ndryshimi e vendimit dhe pranimin e padisë plotësisht.*

## V E R E N

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Fier nr. 62-2018-2188 ( 573 ) dt. 25.04.2018 është marrë në përgjithësi në zbatim të drejtë të ligjit, por duhet të ndryshohet vetëm për masën e dëmshpërblimit duke u detyruar i padituri të dëmshpërblejë paditësin në vlerën prej 4 877 447 lekë për dëmin e shkaktuar. Për rrjedhojë në bazë të nenit 106 të K.Pr.Civile të gjitha shpenzimet gjyqsore t'i ngarkohen të paditurit.

Nga gjykimi i çështjes rezultojnë faktet e mëposhtme: Paditesi ka nje periudhe vjetërsie ne pune prej 40-vjetesh dhe ka qene deri ne ditën e lindjes se ketij konflikti me detyren e drejtuesit teknik (k/inxhinier). Per shkak te angazhimeve te tij politike ne Partine Demokratike ai transferohet ne nje inxhinier te thjeshte sektori ,nderkohe qe sipas shkreses se meparshme nr.8583 prot., dt.12.11.2014 kishte rezultuar se pala e paditur kishte patur ndermend ta çonte ne pozicionin roje. Gjithsesi ,edhe ne pozicionin e punes inxhinier sektori ai kishte pesuar nje renie te ndjeshme ne page pasi nga paga e meparshme mujore prej 110,000 leke ai kishte zbritur ne pagen mujore prej 63,000 leke.

Me pas paditesi kishte kundërshtuar te ofronte shërbimin e tij per shkak se punedhenesi e kishte diskriminuar ne page dhe se vendi i tij i punes ishte larg qendres se banimit. Sipas paditesit ky qëndrim diskriminues i paditesit mbeshetetej ne faktin se ai kishte bindje politike te kunderta me administratorin e shoqerise, pasi qe prej vitit 1991 ai kishte qene themelues i Partise Demokratike Fier dhe pjemarres aktive ne forumet e saj ; ne vitet 1994-2013 kishte qene anetar kryesie i Partise Demokratike ne Fier, ne vitet 2000-2003 anetar i Keshillit Bashkiak i Partise Demokratike, ne vitin 2002-2005 Sekretar i Pergjithshme i PD , Fier , ne vitet 2003-2006 anetar i Keshillit Bashkiak Fier per forcën politike PD ,ne vitin 2009 perfaqesues i PD ,Dega Fier dhe kryetar i KZAZ nr.18, per Zgjedhjet e Kuvendit te Republikës se Shqipërisë , Sekretar organizativ 2009-2013 i PD-se ,Fier. Për vitin 1996-1997 Deputet i Kuvendit te



Republikes se Shqiperise nen siglen e PD-se dhe Qershor i vitit 2015 anetar i grupit qendror ne zgjedhjet lokale te vitit 2015.

Kete fakt paditesi e vertetoi ne gjykim me proven shkresore nr.66 prot, dt. 16.06.2016 te nxjerre prej subjektit politik Partia Demokratike dhe librezes se tij te punes nr.285 rregjistri themeltar , dt.18.03.1974.

Sipas paditësit duke qene ai trajtohej si kundërshtar politik atij nuk i ofrohej nje mjedis i pershtatshem pune, verejtjet qe paraqiteshin prej tij ne lidhje me organizimin e punes, perberjet e komisioneve te kolaudimit me specialiste te mirefillte te fushes perkatese merreshin si kundërshtime te prapavijes politike dhe as qe ekzistonte ndonje mirekuptim qe keto te konsideroheshin si verejtje ne perputhje me ligjet perkatese (ligjet per prokurimet publike). Ishte e natyrshme qe perballe ketij mjedisi te ofruar punedhenesi duke qene pala me " e forte" ne marredhenien e punes ai pa marre pelqimin e tij me shkrim e zbriti menjehere nga detyra dhe me pas duke pretenduar se ai nuk ofronte sherbimin e kishte pushuar nga puna.

Konkretisht, paditësit i eshte zgjidhur kontrata e punes me vendimin nr.577,dt.01.12.2015 te punedhenesit. Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier me vendimin nr.343 ,dt.23.03.2016 ,duke e trajtuar kete si zgjidhje te menjehershme pa shkaqe te justifikuara i ka dhene demshperblimet perkatese paditesit ,vendim ky qe eshte mbajtur ne konsiderate edhe nga Gjykata e Apelit Vlore nr.1078,dt.18.10.2016 e cila ka rritur edhe masen e demshperblimit. Me kete vendim ishte konstatuar se zgjidhja e kontrates se punes me paditesin ishte e pajustificuar pasi nuk provohej qe ai nuk ishte paraqitur ne pune nga data 30.10.2015 deri ne 02.11.2015 , ndërkohë qe data 31 Tetor dhe 1 Nëntor ishin ditë pushimi.

Gjithashtu paditësi i ishte drejtuar Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi i cili me vendim nr.66,dt. 10.08.2017 ka konstatuar diskriminimi i drejteperdrejte i paditesit [REDAKTUAR] nga ana e pales se paditur "Albpetrol",sh.a,Patos, per shkak te bindjeve te tij politike ,si dhe ishte urdheruar rikthimi i tij ne pune. Sipas arsytimit te ketij vendimi rezulton se paditësi ka mbajtur pozicione drejtuese pranë palës së paditur. Ne janar të vitit 2014 është emëruar drejtues teknik i QFMT Patos dhe në datën 01.08.2014 ka nënshkruar një kontratë me afat të pacaktuar. Në datën 19.01.2015 me shkresën nr.15 prot është transferuar si inxhinier në sektorin e QNP Ballsh ku ka punuar deri në Dhjetor 2015 kur është larguar nga puna. Paditësi ka pretenduar se transferimi i tij ishte i paligjshëm pasi sillte ulje në detyre. Po ashtu paditësi ka pretenduar se pushimi i tij nga puna nuk ishte për shkak se kishte munguar në punë, por për shkak të bindjeve politike që i përkasin forcës politike të djathtë të ndryshme nga ajo e drejtuesve të shoërisë Albpetrol . Po ashtu si shkak tjetër për diskriminim është pretenduar mosbindja ndaj urdhërave të paligjshëm, konkretisht me pjesëmarrjen e tij në komisionin e kolaudimit të blerjes së 3 autoboteve, refuzim, që ishte bërë pasi ai nuk ishte specialist i

fushës. Në këtë komision duhet të merrnin pjesë punonjës me profilin inxhinier mekanik dhe transporti. Gjithashtu numri i anëtarëve duhet të ishte 5 dhe jo tre. Më pas me këmbënguljen e tij ai ishte larguar nga ky komision.

Në arsyetimin e vendimit nr.66 dt.10.08.2017 Komisioneri i mbrojtjes nga diskriminimi ka konstatuar ekzistencën e diskriminimit në veprimet e ndërmarra nga i padituri ndaj paditësit duke theksuar se: *Paditësi ka mbajtur detyra të larta drejtuese në Albpetrol Sh.A. për gati 40 vite.. në vitet 2014 e 2015 ai është transferuar në detyra shumë të ulta se profili i tij. Në datën 06.11.2015 është larguar nga puna për mosparaqitje në punë nga data 30.10.2015 , më datën 02.11.2015 e në vazhdim, ndërkohë që mungesat i referohen vetëm datës 30.10.2015 dhe datës 02.11.2015 dhe mungon vazhdimësia. Listprezenca nuk përbën provë pasi në të duhet të evidentoheshin punonjësit që ishin paraqitur në punë dhe ata që mungonin, nuk ka asnjë procesverbal të mbajtur për të verifikuar prezencën ditore të punonjësve në mënyrë që të krijohet bindja se jemi para shkeljeve të paditësit. Mungesa e provave vërteton se veprimtaria e Alpetrolit është dukshëm e njëanëshme dhe diskriminuese. ..Albpetrol sh,a, sipas nenit 82/2 të K.Pr.Administrative ka barrën e provës të vërtetojë se faktet e mësipërmjet nuk përbëjnë diskriminim dhe sjelljet nuk kanë qënë të qëllimshme. Mbështetur në provat e adminsitruara z. Shanaj ka mbajtur disa detyra drejtuese në subjektin politik partia demokratike ..referuar faktit se deri në vitin 2014 ndaj tij nuk është dhënë asnjë masë disiplinore dhe në vazhdimësi për periudhën 2014-2015 ai ka pasur disa lëvizje nga puna dy herë dhe deri në pushimin nga puna të krijojnë bindjen se shkaqet e arsyeshme janë përdorur si pretekse për të fshehur shkakun kryesor të largimit nga puna që janë bindjet politike. Veprimet e Alpetrolit e kanë ekspozuar z. [REDAKTUAR] ndaj trajtimeve të padrejta diskriminuese për shkak të profilit të bindjeve politike. ..lidhur me dëmshpërblimin sipas ligjit nr.10221 dt.04.02.2010 komisioneri nuk ka tagër për dhënie dëmshpërblimi moral dhe ankuesi duhet ti drejtuar gjykatës për ta fituar atë.*

Ky vendim i ketij organi është ankimuar ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Tirane , nga ku kishte rezultuar se qendrimet e komisionerit ishin vlerësuar te drejta dhe se per kete arsye ishte rrezuar edhe padia e ngritur nga "Albpetrol",sh.a,Patos , me vendimin gjyqesor nr.4450(4546),dt. 16.11.2017 . Në këtë vendim gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë ka konstatuar se nga argumentat e paraqitura nga z. [REDAKTUAR] te komisioneri krijohen një prezumim se trajtimi i tij në këtë mënyrë është kryer për motive politike... Albpetroli nuk paraqiti ndonjë provë për të provuar ligjshmërinë e veprimeve të saj ... kjo gjykatë e gjen të drejtë qëndrimin e komisionerit .. nuk gjen shkaqe për pavlefshmërinë absolute të vendimit nr.66 dt.10.08.2017..fakti se komisioneri ka urdhëruar marrjen e masave konkrete duke rikthyer në punë shtetasin [REDAKTUAR] është një vendim brenda kompetecave të tij ,gjykata vlerëson se kjo masë nuk kërkohet në zbatim të nenit 146 të K.Punës por si një masë në shmangie të diskriminimit në zbatim të ligjit nr.10221/2010.

Edhe pas kesaj situatë punedhenesi i tij kishte refuzuar ta pranonte në punë paditesin dhe për këtë shkak ai i ishte drejtuar gjykatës të merrte dëmshpërblimet si rezultat i këtij diskriminimi të kryer dhe të rikthej në punë në bazë të vendimit të komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në hetim të dëmit të shkaktuar të pëditësi si rezultat i diskriminimit me të cilin ai ishte përballur nga veprimet e të paditurit, gjykata e rrethit gjyqsor Fier ka realizuar akte të ekspertimit psikologjik, vlerësues të dëmit pasuror dhe jopasuror të pësuar nga paditësi, si dhe lidhur me gjëndjen e tij shëndetsore nësa ka dëmtime të shëndetit si pasojë e veprimeve diskriminuese dhe shkalla e këtyre dëmtimeve.

Nga akti i ekspertimit psikologjik në konkluzionet e tij eksperti shprehet se: Paditësi demonstroi qartazi elementet e stresit post-traumatik duke ndikuar në disa fusha të ekzistencës dhe duke sjelle ndryshime të mëdha në fushën e sjelljes, sferës somatike, konjutive dhe atë afektive. Tek paditësi është instaluar ndjenja e padrejtësisë, persekutimit dhe diskriminimit duke krijuar bindjen tek ai se ai është pushuar për motive politike. Ai ndihet i pafuqishëm për të ndryshuar këtë situatë duke i shkaktuar në sferën e menduarit pasiguri për të ardhmen, në sferën e sjelljes kufizim social, ndërsa në atë afektive gjendje ankthi, humor depresiv, mungesë interesi dhe kategorizime nën efektet e stresit post-traumatik të përhershëm.

Për efekt të evidentimit të dëmeve ekzistenciale të pësuar, eksperti psikolog në konkluzionet e tij shprehet se: Paditësit, kategorizohen të kenë vetëvlerësim të ulët dhe mesatar (me përkatësitë si më sipër) për veten e tyre. Ky rezultat i kombinuar edhe me rezultatet e metodave të tjera, rezultoi të jetë i ndikuar nga ngjarja traumatike. Ndryshimi i konceptit dhe qëndrimit ndaj jetës dhe të ardhmës, duke marrë qëndrim më pesimist, negativ dhe rrjedhimisht të pasigurt për paditësin në cilësinë e jetës së tij. Ndryshim negativ dhe të varfër në funksionimin në aktivitetet e përditshme jetësore, si socializimi, aktivitetet punësore, aktivitetet familjare, etj., të paditësve dhe ndërhyrësve kryesor. Simptomat dhe reagimet post-traumatike ndikojnë në funksionimin e përditshëm të paditësit dhe në cilësinë e jetës së tij. "

Sipas ekspertit mjekësor -ligjor dhe vlerësues dëmshpërblim nga puna të paditësit vërehen këto dëmtime shëndetsore: depresion aktiv i zgjatur, hipertension arterial, stadi i II DHE III-te, i pastabilizuar, shoqëruar me angina pectoris. Sipas ekspertit mjekësor ligjor paditësi dy muaj pas pushimit nga puna bëri krizë depresive të pesëritura të shoqëruara me gjendje ankthidhe me vone me instalim të HTA esenciale me dhimbje anginoze, të vërtetuara nga konsultat dhe kartela e shtrimit në spital. Si konkluzion i këtij ekspertit dhimbja dhe vuajtja shpirtërore, trauma psikike, stresi, agravon gjendjen shëndetsore të pacientit, si dhe krijon bazë semundje të reja si hipertensioni, neuroza etj... Kjo gjendje kishte shkatëruar paaftësinë në punë të tij në masën 25% referuar kritereve tabelare të evidentuar në rregulloren e miratuar të AMF-se.

Duke ju referuar te dhenave dhe perlllogaritjeve te bera eksperti nxirrte vlerat e demit pasuror dhe jo pasuror ne referencat minimale dhe maksimale. Konkretisht eksperti ka perlllogaritur vleren e demit pasuror nisur nga shkalja e demtimit te shendetit prej 25 %, koeficientin e daljes ne pension sipas moshes se paditesit 0,9 pagën neto të paditesit për një vit nga rezultojnë shumën e demshpërblimit për demin pasuror është 1727 583 lekë. Ndërsa lidhur me demin biologjik vlera është perlllogaritur në bazë të pagës mesatare vjetore sipas të dhënave të institutit prej 54 000 lekë në vitin 2015 dhe në vit 648 000 lekë. Duke qënë se koeficientët e tjerë janë të njëjtë dhe përqindja e demtimit të shendetit 25 % është konkluduar se vlera e demit biologjik është 1574 932 lekë. Mbi këtë bazë është llogaritur vlera e demit moral në kufijtë nga ¼ dhe ½ e demit biologjik, që është 393733 lekë dhe 787466 lekë. Në të njëjtat vlera janë edhe kufijtë minimal dhe maksimal të demit ekzistencial. Në vlerën e demit maksimal jopasuror eksperti ka perlllogaritur gjithë vlerën e demit biologjik prej 1574 932 lekë + 2 x 393 733 lekë, që është vlera minimale e secilit prej dëmeve moral dhe ekzistencial në shifrën ¼ nga rezultojnë në përfundim vlera e demit minimal jopasuror prej 2 362 398 lekë, ndërsa në vlerën maksimale të demit jopasuror është mbajtur në konsideratë vlera prej ½ e demit moral dhe ekzistencial prej 787 466 lekë nga del shumën gjithsej me gjithë demin biologjik në masën 3149 864 lekë. Duke u mbledhur të dy këto shifra me vlerën e demit pasuror e cila është e pandryshueshme prej 1727 583 lekë atëherë vlera totale e demit pasuror e jopasuror variojnë në vlerën minimale prej 4098 981 lekë dhe vlerën maksimale prej 4877 447 lekë.

Paditesi ka pretenduar se është diskriminuar nga vendimet e padrejta dhe të ndikuara politikisht të punedhënesit pasi:

a-Rezultojnë se konflikti me i mprehte me punedhënesin e tij ka ardhur kur ai për shkak të njohurive dhe përvojës së tij në punë i ka sugjeruar atij të mos përfshihet si anëtar i komisionit të kolaudimit. Përberja e komisionit në lidhje me marrjen në dorezim të mallit "Blerje autobote me cisternë për transportin e naftës brut, gjithsej 3-cope" duhej të ishte me specialist përkatës, inxhinier mekanik, ndërsa ai në rastin konkret dispononte diplomë me titullin "Inxhinier prodhimi" të lëshuar prej Fakultetit të Gjeologjisë -Minierave të Universitetit të Tiranës.

b-Këtë fakt e kishte pranuar edhe punedhënesi i tij ku me urdherin nr.2382/16 prot, dt.30.06.2014 kishte ndryshuar përberjen e komisionit teknik të kolaudimit dhe konkretisht paditesi ishte zëvendësuar me një specialist përkatës nga fusha e inxhinierisë mekanike.

c-Pas këtij momenti punedhënesi duke e parë dhe trajtuar si një kundërshtar politik dhe pengesë në vendimarrjen e tij e kishte zbritur fillimisht në detyrë pa pëlqimin e tij dhe me pas e kishte pushuar përfundimisht nga puna.

d-Ai në këtë mënyrë kishte shkelur trajtimin e barabartë të shtetasve në lidhje me përzgjedhjen dhe mbajtjen në detyrë të punëmarrësve si dhe mënyrën e trajtimit të tij gjatë ndryshimit të kushteve të punës . Punedhënesi i tij e kishte trajtuar në mënyrë të disfavorshme dhe me pasoja negative , me keqdashje , si

dhe nuk ishte pare me objektivitet pervojen e tij ne pune dhe arsimimin , faktin e largesise se vendit te tij te punes nga qendra e banimit, si dhe uljen e ndjeshme te tij ne page duke sjelle dukshem perkeqesim te anes se tij ekonomike.

e-Pas zgjidhjes se marredhenies se tij punes ai kishte perjetuar prej shume muajsh ,gjendje stresi, ankthi,pasigurie,depresioni,duke pasjelle demtim te rende te shendetit te tij.

f-Paditesi pretendoi se diskriminimi i tij ekzistonte ne formë te drejtperdrejte, pasi sipas tij ai ishte trajtuar ne menyre me pak te favorshme nga grupi i kualifikimit qe i perkiste,pasi gjendja e tij ekonomike ne familje nuk paraqitej e favorshme dhe kjo kishte çuar në gjendje te pakenaqeshme edhe te gjendjes shendetsore te tij, ku faktorizohet depresioni dhe hipertensioni arterial.

g-Sipas Flet-daljes se Spitalit Amerikan ,Tirane, rezulton se ai i eshte neshtruar procedures se sukseshme revaskularizimit te deges diagonale nepermjet angioplastikes me implantimin e nje stenti te medikuar . Sipas rekomandimit nr.1078 ,dt.24.01.2018 te mjekut te familjes dignostikohet edhe me depression reaktiv te zgjatur ku eshte futur ne trajtim me ane te medikamenteve.Kjo situatë kishte çuar dukshem ne perkeqesim te gjendjes shendetosore ku nderhyrja e mjekeve kishte qene vendimtare dhe shkaku vendimtar kishin qenë veprimet diskriminuese te punedhensit te tij.

Gj-Edhe pas vendimin nr.66,dt. 10.08.2017 te Komisionerit Per mbrojtjen nga Diskriminimi që kishte kosntatuar diskriminimi i drejteperdrejte i paditesit [REDACTED] nga ana e pales se paditur "Albpetrol",sh.a,Patos dhe kishte urdhëruar rikthimi i tij ne pune, përsëri i padituri kishte refuzuar ta pranonte ne pune paditesin .

h-Ndodhur ne keto rrethana ku ekzistonte nje lidhje shkaksore midis veprimeve dhe mosveprimeve te pales paditese me pasoje demtimin e shendetit te tij ,kerkohej qe te pranohej kerkimi i tij ne lidhje me demshperblimin e tij pasuror dhe jopasuror si dhe kerkimet e tjera te padise se tij.

#### I padituri ka prapsuar se:

a-Sipas palës së paditur, paditesi nuk legjitimohej aktivisht në ngritjen e kësaj kërkesëpadie, pasi nga ana e palës së paditur nuk ishte kryer asnjë veprim i paligjshëm dhe me faj, që mund të ketë shkaktuar pasojën e ardhur, pushimi nga puna te paditesit dhe me pas demtimin e tij nga pikpamja shendetsore. Në rastin konkret, sipas palës së paditur mungonte lidhja shkakësore, mungonte veprimi i paligjshëm dhe rrjedhimisht ajo si pala e paditur nuk legjitimohej pasivisht.

b-Pala paditese i ishte nenshtruar pushimit nga puna sipas Kodit te Punes si pasoje e shkeljes se detyrimeve te tij kontraktuale sipas nenit 153 te Kodit te Punes dhe se ai kishte marre demshperblimin perkates ne lidhje me kete fakt ,ndersa rikthimi i tij ne vendin e meprshem te punes gjendej i pabazuar pasi ai nuk ishte i punesuar ne nje organ publik.

Mbi këto rrethana Gjykata e rrethit gjyqsor Fier me vendimin nr. nr. 62-2018-2188 ( 573 ) dt. 25.04.2018 ka vendosur pranimin e padisë pjesërisht me

arsyetimin se; Në lidhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se paditësi ka legjitimitet aktiv për të paraqitur padinë e shpërblimit të dëmit jo pasuror. Gjatë gjykimit, paditësi ka pretenduar se ai ka pësuar një dëm pasuror dhe jopasuror. Sipas paditësit atij si subjekt i drejtpërdrejtë i janë cënuar të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme dhe për rrjedhojë, ai legjitimohet aktivisht në ngritjen e padisë objekt gjykimi. Legjitimimi aktiv i paditësit gjen mbështetje edhe në vendimin unifikues Nr. 12, datë 14.09.2007, në të cilin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.. paditur në këtë proces gjyqësor. Referuar pretendimeve të paditesit, rezulton se ky i fundit pretendon shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosveprimet me faj të palës së paditur. Në këto kushte, duke vlerësuar se paditesi është cenuar nga pikpamja pasurore dhe jopasurore si pasoje e diskriminimit të tij, i punësuar pranë palës së paditur, gjykata vlerëson se kjo palë ka legjitimitet pasiv në çështjen objekt gjykimi... Kështu, padia objekt gjykimi mbështetet në ngjarjen e ndodhur në datën dt.01.12.2015 ku rezulton të ketë humbur punën paditesi si pasoje e një shkaku diskriminues, i cili përbën faktin e paligjshëm. Ky fakt i paligjshëm u kundërvihet të drejtave subjektive të paditesave, të drejtave të tilla si mirëqënia shpirtërore dhe mënyra e jetesës, që gjejnë mbrojtje dhe garanci nga rendi juridik i Republikës sonë. Në këtë mënyrë formësohet shkaku ligjor i padisë dhe i objektit të saj, që në fund të fundit është rivendosja në vend i të drejtave të shkelura e të cënuara nga fakti i paligjshëm. Mënyra se si ligji ka parashikuar të ndodhë kjo rivendosje e të drejtave dhe që në rastin konkret është disponuar në padi nga paditësi është dëmshpërblimi jopasuror jashtëkontraktor për të gjitha dëmet e pësuar nga fakti i paligjshëm, duke u formësuar ndër të tjera edhe baza juridike e këtyre kërtimeve si p.sh. neni 608 apo neni 625 i Kodit Civil, neni 37/1 të ligjit specifik nr. 10221, dt.04.02.2012 "Per mbrojtjen nga diskriminimi",.. Në rastin konkret, marrëdhënia juridike që ka arritur të shndërrohet deri në një konflikt gjyqësor në këtë proces nuk rrjedh nga një kontratë apo veprim juridik i vullnetshëm i palëve ndërgjyqëse. Marrëdhënia juridike objekt gjykimi rrjedh nga fakti i paligjshëm dhe për këtë Gjykata ai qendron në **diskriminimin politik të paditesit nga vendimet e padrejta të punedhënesit**. Ai ka shkelur trajtimin e barabarate të shtetasve në lidhje me perzgjedhjen dhe mbajtjen në detyrë të punemarresve në detyrë si dhe mënyrën e trajtimit të tyre pa qenë nevoja e ndryshimit të kushteve të punës. Punedhënesi ka trajtuar në mënyrë të disfavorshme dhe me pasoja negative paditesin, me neglizhence, si dhe nuk ka parë me objektivitet gjendjen ekonomiko-familjare të tij. Në qoftë se do të ishte parë me objektivitet kjo situatë nga punedhënesi dhe në përputhje me kriteret e punësimit ai nuk do të perfshihej në këtë zgjidhje abuzive të kontrates së punës. Gjykata cmon se jemi para një marrëdhënie dëmshpërblimi jashtëkontraktor, për t'iu nënshtruar në këtë mënyrë kështu të gjithë regjimit juridik përkatës të treguar nga paditësit por edhe të zbatuar nga Gjykata sipas parimit, që gjykata e njeh ligjin (curia novit jura, shiko neni 16 të Kodit të Procedurës Civile)... Referuar shkaktimit ligjor të kërimit, objektit dhe bazës ligjore të padisë rezulton qartë se jemi para padisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor. Gjykata vlerëson se përgjegjësia jashtëkontraktore për shpërblimin e dëmit, njihet ndryshe si përgjegjësia akuiliane (lex aquilia de damno), ku, cilido që shkel të drejtat dhe interesat e tjetrit detyrohet t'a dëmshpërblejë atë. Me anë të dëmshpërblimit synohet rivendosja e plotë e të dëmtuarit (restitutio in integrum) në gjëndjen e mëparshme, në të cilin personi do të ndodhë nëse nuk do të kishte ndodhur fakti i paligjshëm... Gjykata vlerëson të marrë në analizë faktin nëse në rastin konkret, ekziston një veprim ose mosveprim i paligjshëm i palës së paditur, në kuadër të shkëlqes së rregullave të kodit të punës në lidhje me punonjesi që do të neshtroheshin pushimit. Në lidhje me këtë pikë, gjykata vlerëson se ekzistenca e veprimit ose mosveprimit të paligjshëm në kuadër të

plotësimi të një prej elementëve të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, jo domosdoshmërisht duhet të jetë në nivelin e një vepre penale. Veprimi ose mosveprimi i paligjshëm, nënkupton një veprim ose mosveprim në kundërshtim me normat e rendit publik ose zakoneve të mira... Në këtë mënyrë, në çështjen objekt gjykimi ekziston figura e dëmit biologjik pasi paditesi ka pesuar dem shendetsor keshtu qe ai sipas ekspertit te fushes, në mënyrë që më pas të kryhen operacionet e përlllogaritjes së dëmit moral dhe ekzistencial mbi atë shumë, duke njohur kështu vlerën e të panjohurës në këtë ekuacion matematikor ligjor... Gjendja shendetsore e agravuar e paditesit para zgjidhjes se kontrates se punes nuk u provua me ndonje prove shkresore nga pala e paditur ,keshtu qe kjo Gjykate bazuar edhe ne konkluzionet e ekspertit mjeko- ligjor arrin ne perfundimin se kjo gjendje ka precipituar si pasoje e humbjes arbitrare te vendit te punes se tij... Gjykata vlerëson se humbja e punes se paditesit si dhe trajtimi diskriminues politik ne zgjidhjen e kontrates se punes , ka tronditur thellë ndjenjat sublime të sferës shpirtërore dhe psikologjike te paditesit dhe antareve te familjes se tij. Pas humbjes së punes, paditësi ka patur ndryshime thelbësore në mënyrën e jetesës së tij duke u tërhequr nga jeta sociale, si dhe duke u tronditur thelbësisht ne jetën personale, familjare dhe sociale të tij. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se i padituri nuk paraqiti asnjë argument apo provë për të kundërshtuar ekzistencën e dëmit ekzistencial, vetem u paraqiti si prapsim se kjo gjendje tek paditesi nuk ishte shkaktuar nga humbja e punes se paditesit... Gjykata duke ju referuar faktit ne fjale i rezulton se paditesi ka qene i punesuar prane te paditures me një page te caktuar sipas kontrates se punes se lidhur me te. Kjo Gjykate i referohet shumes se demshperblimit te perlllogaritur prej ekspertit [REDACTED], te cilen i demtuari duhet ta perfitojne minimalisht ate. Sipas ekspertit mjeko -ligjor dhe vleresues demesh mbas largimit nga puna te paditesit verehen keto demtime shendetsore depresion aktiv i zgjatur ,hipertesion arterial ,stadi i II DHE III-te, i pastabilizuar ,shoqeruar me angina pectoris... Në lidhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se në analizë tërësore të fakteve dhe provave objekt gjykimi, arrihet në përfundimin se humbja e punes se paditesit dhe diskriminimi i tij ne perzgjedhjen e pushimit nga puna eshte veprim i paligjshem i punedhenesit. Në këto kushte, gjykata vlerëson se ka një lidhje shkakësore të drejtpërdrejtë ndërmjet faktit të paligjshëm (humbjes se punes se paditësit nga veprimet e paligjshme te punedhenesit) dhe dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar atij nga ky fakt i paligjshëm... Në sintezë të analizës së mësipërme, gjykata vlerëson se pala e paditur i ka shkaktuar paditësve një dëm pasuror jo pasuror si rezultat i mosveprimeve të kryera me faj (për sa kohë që nga pala e paditur nuk u provua e kundërta)... Gjykata cmon se kjo mase demshperblimi duhet te kufizohet ne kufirin minimasl te akt-ekspertimit te vleresimit te demit ne shumen 4,098,981 (kater milion e nentedhjete e tete mije e nenteqind e tetedhjete e nje mije ) lekë. Gjykata se kjo mase demshperblimi i pergjigjet natyres se demshperblimit pasi paditesi nuk solli prova ne gjykim per te vertetuar qe gjendja e tij ekonomike ne familje eshte ne ate gjendjes sa legjitimohet per ta perfituar ate maksimalisht. Ne lidhje me rikthim ne vendin e meparshem te punes kjo Gjykate cmon se ky kerkim i paditesit gjendet i pabazuar pasi ne lidhje me kete fakt sipas VUC m. 19/2007 nuk mund te konfondohen demshperblimi dhe rikthimi ne vendin e meparshem te punes ,keshtu qe perderisa vete paditesi ka pranuar demshperblimin nga zgjidhja e kontrates , ky kerkim perben tashme "gje te gjykuar" .

## Ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes

Neni 14 i Konvetës evropiane të të drejtave të njeriut

kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij.

16. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjorbë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas Kodit të Procedurës Civile.

17. Gjoha derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 34

Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile **për dëmshpërblim sipas ligjit** ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

2. Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale.

Neni 36

Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuarimerr dijeni për këtë sjellje....

5. Padiësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese.

6. Pasi padiësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.

Neni 37 Vendimi i gjykatës

1. Vendimi i gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit. 2. Vendimi i gjykatës u komunikohet të gjitha palëve të interesuara, përfshirë komisionarin. 3. Vendosja e masave, sipas këtij ligji, nuk përjashton vendosjen e masave sipas ligjeve të tjera.

Neni 38

Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e dukur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme.

Kodi I punes

Neni 9/2 Me "diskriminim" kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike, fetare ose filozofike**, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

Neni 10 i ndryshuar me ligjin nr.136/2015 dt.05.12.2015

10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose padiësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.



## **Vlerësimi i gjykatës së Apelit lidhur me zgjidhjen e çështjes.**

Gjykata e Apelit cmon se shkaqet e ankimit të ngritura nga paditësi kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Fier nr. 62-2018-2188 ( 573 ) dt. 25.04.2018 janë të bazuara pjesërisht lidhur me masën e dëmshpërblimit duke u ndryshuar vendimi në pikën 4 dhe 5 të tij. Nga provat e marra në gjykimin në shkallë të parë u konstatua diskriminimi i paditësit për shkak të bindjeve të tij politike dhe dëmi maksimal i shkaktuar nga sjellja e të paditurit në vazhdimësi jo vetëm në momentin e zgjidhjes së kontratës së punës, por edhe më pas në moszbatimin e vendimit të komisionerit për ndreqjen e situatës së paligjshmërisë për rikthimin në punë të paditësit pasi ky vendim nuk rezultoi të jetë zbatuar nga i padituri. Pretendimet e ngritura në ankim nga i padituri dhe zyra vendore e avokatrës së shtetti Vlorë rezultojnë të jenë të pabazuara. Vendimi i gjykatës së rrethit gjyqsor Fier duhet të lihet në fuqi duke u rritur masa e dëmshpërblimit në favor të paditësit në vlerën 4877447 lekë për sa mëposhtë;

1-Paditësi ka bazuar padinë për konstatimin e diskriminimit në marrëdhënien e punësimit dhe pagimin e dëmshpërblimit ndër të tjera në ligjin nr.10221 dt.04.02.2010. Në bazë të dispozitave të ligjit nr.10221 vlerësohet se për të qene perpara nje veprimi diskriminues ne kuptim te ketij ligji, duhet te plotesohen ne menyre te njekohshme keto kushte:

*1 - te ekzistojte nje trajtim i diferencuar i personit ne raport me te tjeret, te cilet ndodhen ne rrethana te njejta apo te ngjashme;*

*2 - trajtimi i diferencuar te kete ndodhur per nje nga shkaqet e parashikuara ne nenin 1 te ketij ligji;*

*3- trajtimi i diferencuar te kete sjelle si pasoje veshtiresine apo pamundesine e ketij personi per te ushtruar te drejtat dhe lirite e njohura nga kushtetuta, aktet nderkombetare te ratifikuara apo ligje te tjera ne fuqi ,*

Edhe sipas kodit të punës, që konsiderohet ligji i posacëm me fuqi hierarkike më të lartë për rregullimin e marrëdhënieve punëdhënës- punëmarrës është e parashikuar se diskriminim përbën *çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, .bindjeve politike... në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.* Pra në thelb të evidentimit të një sjellje diskriminuese qëndron trajtimi i diferencuar, që i bëhet një personi në raport me të tjerët, që ndodhet në të njëjtat rrethana me të nga i njëjti punëdhënës. Paditësi në rastin konkret pretendon se i padituri kë bërë një sjellje diferencuese të pajustificuar ndaj tij lidhur me trajtimin e tij gjatë marrëdhënies së punës në vitet 2014-2015, transferimit të njëanëshëm, zgjidhjes së kontratës së punës për shkak të bindjeve të tij politike të ndryshme nga ajo e drejtuesve të shoqërisë, si dhe për shkak të moszbatimit të urdhërave të paligjshme për pjesëmarrje në komisione për blerje të mjeteve. Sipas paditësit transferimi fillimisht në detyrën e rojës dhe më pas si inxhinier në

Ballsh ndërkohë që kishte qënë drejtues teknik në Patos, që kishin sjellë uljen e dukshme të pagës dhe të vendit të punës e shoqëruar më pas me vendin e datës 06.11.2015 me zgjidhjen e kontratës së punës për mosparaqitje në punë, tregojnë se ai ishte trajtuar në mënyrë diferencuese në shkelje të parimit të barazisë së shtetasve në realizimin e të drejtës së tyre për punës Pra në thelb pretendohet se sjellja diskriminuese ka të bëjë me cënimin e të drejtës së paditësit për punësim në ndryshim nga punonjësit e tjerë, që kishin të njëjtën aftësi profesionale me të.

Nga hetimi gjyqsor u provua se i padituri ka bërë një trajtim të ndryshëm të paditësit në ndryshim nga punonjësit e tjerë pas vitit 2014 deri në vitin 2015 kur është vendosur zgjidhja e kontratës së punës me të. Kështu;

a-Megjithëse paditësi ka punuar në vazhdimësi pranë të paditurit për një periudhë 40 vjecare dhe ka mbajtur përgjithësisht pozicione drejtuese, ai nuk ka pasur masa disiplinore të dhëna ndaj tij dhe as ndryshime të dukshme të vendit të punës ose të pagës deri në vitin 2014. Në vitet 2014-2015 ai është përballur dy herë me transferime të pozicionit të punës së tij në vende dukshëm më të ulta se ato, që ai ka mbajtur paraprakisht dhe me pagë më të ulët. Ndryshimi i sjelljes së punëdhënësit ndaj tij si punëmarrës në këtë periudhë ndërkohë, që nuk kishte asnjë vlerësim të performancës në punë të paditësit në këtë periudhë, që ndryshonte nga vitet e mëparëshme krijojnë bindjen se sjellja e punëdhënësit ishte pasojë e bindjeve të ndryshme politike, që kishte punëmarrësi nga strukturat drejtuese të punëdhënësit.

b-Është fakt që në Shqipëri pas zgjedhjeve politike të vitit 2013, ndryshuar strukturat drejtuese të shoqërisë Albpetrol Sh.A, e cila është një kompani private me kapital tërësisht shtetëror. Në këto kushte paditësi si pjesë e strukturave të deklaruara të partisë politike demokratike të Shqipërisë është përballur me një trajtim diferencues në transferimin në pozicione pune më të ulta se aftësitë e tij profesionale dhe me pagë më të ulët, rrethana, që provojnë se trajtimi i tij diferencues ishte pasojë e bindjeve të tij politike të shfaqura publikisht.

c-Intesiteti i transferimeve me të cilat është përballur paditësi për vitet 2014-2015 dhe më pas pushimi i tij nga puna me shkresën e datës 06.11.2015 për shkak se kishte munguar vetëm dy ditë në punë, vërtetojnë se ai ka qënë viktimë e trajtimit diskriminues për shkak të bindjeve politike nga punëdhënësi. Me vendimin nr.343 ,dt.23.03.2016 të Gjykatës së rrethit Fier dhe atë të gjykatës së Apelit nr.1078/2016 është provuar se zgjidhja e kontratës së punës e bërë nga i padituri ka qënë pa shkaqe të justifikuara pasi nuk provohej mosparaqitja në punë e paditësit as në datën 30.10.2015 dhe atë 02.11.2015 e as në vazhdimësi.

d-Gjithashtu trajtimi diskriminues i paditësit nga i padituri ka ardhur edhe për shkak të qëndrimeve që paditësi si punëmarrës ka mbajtur ndaj urdhërave të dhëna nga i padituri lidhur me pjesëmarrjen e tij në komisionin për blerjen e 3

autoboteve, urdhër i dhënë në datën 30.06.2014. Padiësi e ka kundërshtuar pjesëmarrjen e tij duke vlerësuar se nuk kishte njohuritë e posacme si inxhinier mekanik ose transporti për blerjen e tyre dhe numri i anëtarëve gjithësej duhet të ishte 5 dhe jo 3. Me urdhërin e datës 06.10.2014 administratori i albpërolit e kishte kaluar atë në anëtar të komisionit nga kryetar dhe më pas me urdhërin e datës 21.10.2014 po për shkak të qëndrimit të padiësit për dorëheqjen nga ky pozicion pasi nuk kishte njohuritë inxhinier e kishte larguar nga përbërja e këtij komisioni. Vetëm disa ditë më vonë nga kjo dorëheqje, i padituri me shkresën e datës 12.11.2014 kishte ndryshuar pozicionin e punës së padiësit nga kryeinxhinier në qëndrën Patos në inxhinier në zonën e parë të sektorit të dytë pranë qëndrës Patos. I padituri ka pretenduar në procedurën administrative të kryer pranë komisionerit publik se ky transferim nuk është zbatuar në fakt dhe padiësi është paguar si dretjues teknik. Ndërsa padiësi ka kontestuar se është cuar të punojë si roje dhe kjo e ka detyruar atë të pranojë transferimin si inxhinier i thjeshtë në Ballsh. Gjykata e Apelit duke vlerësuar në tërësi mënyrën se si është transferuar padiësi nga pozicioni drejtues teknik në mënyrë të njëanëshme nga i padituri dhe realizimin e këtij urdhëri menjëherë pas dorëheqjen së padiësit nga anëtarësia e komisionit të blerjeve të autoboteve, pranimin e padiësit të shkojë në një detyrë më të ulët se pozicioni i tij i mëparëshëm i punës dhe me një pagë shumë të më vogël, provojnë se i padituri ka realizuar një sjellje diskriminuese ndaj padiësit duke e viktimizuar në atë masë sa e ka detyruar të heq dorë nga të drejtat e tij si punëmarrës.

e-Fakti i diskriminimit të padiësit është e provuar me vendimin nr.66 dt.10.08.2017 të komisionerit të mbrojtës nga diskriminimi, i cili jo vetëm që ka konstatuar një fakt të tillë, por ka urdhëruar marrjen e masave për ndreqjen e situatës së paligjshmërisë duke urdhëruar kthimin e padiësit në punë, mase e cila nuk është zbatuar nga i padituri. Megjithëse i padituri e ka ankimuar vendimin e komisionerit në gjykatën Administrative, kjo e fundit me vendimin nr.4450(4546),dt. 16.11.2017 ka rrëzuar padinë duke gjetur të drejtë vendimin e komisionerit. Pavarësisht se vendimi i komisionerit aktualisht ka marrë formë të prerë rezulton se i padituri nuk ka ekzekutuar vullneratisht masën për rikthimin në punë të padiësit, gje që tregon se gjëndja diskriminuese e trajtimit të padiësit vazhdon dhe nga i padituri nuk është treguar asnjë vullnet për rikuperimin e kësaj situatë paligjshmërie.

f-Vendimi i komisionerit për konstatimin e faktit të diskriminimit të padiësit nga i padituri konsiderohet detyruës për palën e paditur dhe gjykatën civile. E vetmja mënyrë se si pala e paditur mund ta kontestonte këtë vendim ka qënë ankimi në gjykatën administrative, ankim që është rrëzuar. Në këto kushte pretendimet e ngritura në ankim nga i padituri se nuk ka diskriminuar në marrëdhënien e punësimit palën paditëse konsiderohen se kanë rënë në dekladencë.

Nisur nga këto prova vëretetohet i padituri ka bërë një sjellje diferencuese në marrëdhënien e punësimit me padiësin në raport me të punësuarit e tjerë të shoqërisë në të njëjtat rrethana si në transferimin e tij deri në zgjidhjen e kontratës së punës , madje edhe më pas në mungesën e vullnetit të rregullimit

të situatës së paligjshmërisë për ta rikthyer në punë paditësin. I padituri nuk paraqiti asnjë provë se për cilin shkak kishte bërë një trajtim të ndryshëm të paditësit në punësim në raport me punonjësit e tjerë të punësuar në të njëjtat kushte me të, megjithëse në bazë të nenit 10 të K.Punës kishte detyrimin për të provuar një gjë të tillë, pasi paditësi ka sjellë prova që faktojnë indicie për një trajtim diskriminues të tij. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga komisioneri i mbrojtjes nga diskriminimi në vendimin nr.66 dt.10.08.2017.

Sipas nenit 36 të ligjit nr.10221 „Për mbrojtjen nga diskrimi“ gjykata e Apelit cmon se paditësi ka paraqitur një bazë të mjaftueshme provuese në mbështetje të padisë së ngritur prej tij. Në këto kushte gjykata e Apelit cmon se sipas nenit 36/6 të ligjit nr.10221 nga provat e paraqitura nga paditësi provohet sjellja diskriminuese, që ka bërë i padituri dhe i takon barra e provës këtij të fundit që të provojë se faktet e paraqitura nga paditësi nuk përbëjnë diskriminim. Si në gjykimin në apel dhe në shkallë të parë i padituri nuk ka paraqitur asnjë provë për të rrezuar pretendimin e paditësit duke i mëshuar faktit se ka bërë transferimet dhe zgjidhja e kontratës së punës nuk është bërë për shkak të diskriminimit. Po ashtu i padituri ka pretenduar se paditësi është trajtuar me dëmshpërblim për zgjidhje të menjëherëshme të kontratës së punës me vendimin nr.343 ,dt.23.03.2016 të lënë në fuqi nga gjykata e Apelit , madje duke iu rritur masa e dëmshpërblimi. Gjykata e Apelit cmon se përfitimi nga paditësi i dëmshpërblimeve për zgjidhje të menjëherëshme të kontratës së punës sipas nenit 153 e vijues të këtij kodi nuk pengon të drejtën e paditësit të kërkojë pagimin e dëmshpërblimeve përkatëse për zgjidhjen e kontratës së punës në kushtet e diskriminimit sipas ligjit nr.10221/2010 ose nenit 146 të K.Punës. Instituti i zgjidhjes së menjëherëshme të kontratës së punës i rregulluar nga neni 153 e vijues i K.Punës është i ndryshëm nga ai i zgjidhjes së kontratës së punës për shkaqe të paarsyeshme, ku përfshihet edhe rasti i diskriminimit për shkak të bindjeve politike i trajtuar nga neni 146 i K.punës. Madje vetë ligji nr.10221/2010 përcakton se viktimat duhet t'i ngrejë pretendimet për dëmshpërblim para gjykatës, pasi është kjo e fundit organi kompetent për dëmshpërblimet sipas nenit 34 të ligjit. Një gjë e tillë është cituar edhe nga komisioneri publik në vendimin nr.66/2017 duke e orientuar paditësin që kërkimet e tij për dëmshpërblim ti paraqes para gjykatës.

Në rastin e padive me objekt konstatim diskriminimi në marrëdhënien e punësimit, fusha e veprimit të këtij instituti shtrihet jo vetëm në përfundimin e marrëdhënieve të punës në mënyrë të parregullt, por edhe në ato që formalisht nga pikëpamja ligjore duket të bazuara në ligj, si edhe në trajtimin e ndryshëm të punëmarrësit gjatë marrëdhënies së punësimit konkretisht lidhur me transferimet, uljen e pagës, mungesës së ripunësimit megjithë vendimin e dhënë për rikuperimin e gjëndjen së paligjshmërisë së konstatuar nga komisioneri etj. Në analizë të të gjitha provave të sipërcituara provohet se paditësi është trajtuar në mënyrë diskriminuese jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së kontratës së punës, por edhe të trajtimit të tij në kushte të barabarta me punonjësit e tjerë gjatë periudhës së punësimit për shkak të bindeve të tij politike dhe të qëndrimeve që

ai ka mbajtur në mosbindjen ndaj punëdhënësi për urdhërat e dhëna prej tij gjatë procesit të punës, megjithëse mosbindja nga këto urdhëra nuk është konsideruar si thyerje e disiplinës në punë nga vetë punëdhënësi.

Cënimi i të drejtës së paditësit për punësim ka sjellë vështirësi në ushtrimin e të drejtave kushtetuese si është frekuentimi dhe shfaqja e bindjeve politike, ndërkohë që punëmarrësi nuk ka cënuar në asnjë rast marrëdhënien e punësimit të tij me palën e paditur. Gjithashtu largimi i tij nga puna përbën një shembull negativ për cënimin e ushtrimin e të drejtës kushtetuese sic është liria e shprehjes dhe pjesëmarrjes në parti politike, si shfaqje dhe pranim i bindjeve të ndryshme politike në një shoqëri demokratike.

Nga sa mësipër gjykata e Apelit vlerëson se plotësohet të tre kushte ligjore të parashikuara nga ligji nr.10221 dhe neni 9-10 i Kodit të punës duke u provuar se paditësi ka qënë viktimë e trajtimit diskriminues në marrëdhënien e punësimit të tij nga pala e paditur. Prandaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka pranuar padinë duke u konstatuar ekzistenca e diskriminimit të paditësit.

2-Gjykata e Apelit gjen të drejtë rrëzimin e padisë nga gjykatat e shkallës së parë Fier lidhur me pjesën e kërimit të paditësit për kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës. Zgjidhja e kontratës së punës nga i padituri pa shkaqe të arsyeshme konkretisht për shkak të bindjeve politike përbën një shkak abuzim dhe e drejta që punëmarrësi mund të rivendos nëpërmjet rrugës gjyqësore është ajo e dëmshpërblimit dhe jo ajo e rikthimit në punë. Kështu në nenin 146/3 të K.Punës parashikohet se; *Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit page, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prere për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.* Pra përjashtimisht e drejta e rikthimit në punë njihet për punonjësit e administratës publike cilësi, që nuk e gëzon paditësi.

Gjithashtu edhe në bazë të ligjit nr.10221/2010 , kërkitimi i paditësit për rikthimin në punë konsiderohet i zgjidhur me vendimin e dhënë nga komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret konstatohet se e drejta e rikthimit në punë e pretenduar nga paditësi është njohur me vendimin nr.66 dt.10.08. 2017 të komisionerit të mbrojtjes nga diskriminimi i cili ka urdhëruar palën e paditur të rimarrë në punë paditësin, si një nga masat që ka të bëjë me riparimin e gjëndjes së paligjshmërisë. Ky vendim është i detyrueshëm për të paditurit në bazë të ligjit nr.10221/2010. Në kuadër të ekzekutimit të këtij vendimi komisioneri ka të drejtë të marrë një sërë masash të parashikuara nga neni 33 i ligjit nr.10221/2010 duke filluar nga dënimet me gjobë e deri në heqjen ose pezullimin e lejes së veprimtarisë së personit fizik ose juridik. Në këto kushte është detyrimi i organit administrativ Komisioneri i mbrojtjes nga

diskriminimi të marrë të gjitha masat administrative të parashikuar në ligj për të detyruar të paditurit të zbatojë urdhërimet e marra prej tij në vendimin nr.66 dt.10.08.2017. Për të realizuar të drejtën e tij të rikthimin në punë paditësi duhet ti drejtohet komisionerit të mbrojtjes nga diskriminimi për marrjen e masave administrative ndaj të paditurit dhe vetëm në rast se këto masa nuk sjellin efekt ai ka të drejtë të kërkojë nga gjykata pagimin e dëmshpërblimit për pasojat, që i kanë ardhur nga moszbatimi i këtij vendimi të organit administrativ nga i padituri.

3-Paditësi ka pretenduar se si pasojë e diskriminimit ai duhet të dëshmpërblehet për dëmin pasuror dhe atë jopasuror në të gjitha figurat e tij duke iu referuar për këtë neneve 608 e vijues të K.Civile dhe ligjit të posacëm nr.10221. Megjithëse ky i fundit parashikon në nenin 36-38 të drejtën e personave të kërkojnë dëshmpërblim për shkak të diskriminimit nuk përcakton ndonjë kriter për realizimin e këtij dëmshpërblimi, por referon te fakti se paditësi ka të drejtë të kompesohet me qëllim rikuperimin ose ndërprerjen e gjëndjen së paligjshmërisë së krijuar si pasojë e diskriminimit.

Në rastin konkret kërkimi i paditësit për dëmshpërblim gjen mbështetje në ligjin nr.10221 dhe në nenin 625 të K.Civil, i cili parashikon se ka të drejtë të dëmshpërblehet cdo person që cënohet në nderin e reputacionin e tij nga fakti i paligjshëm i kryer nga i padituri. Prandaj gjykata e Apelit cmon të drejtë e të bazuar shkakun ligjor, ku paditësi është bazuar në kërkimin e dëmshpërblimit si pasojë e veprimit të paligjshëm diskriminues të të paditurit, por vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë për masën e dëmshpërblimit duhet të ndryshohet pasi nuk i përgjigjet dëmit real pasuror dhe jopasuror që ka pësuar paditësi nga sjellja e paligjshme e të paditurit.

Paditësi ka pësuar dëm pasuror dhe jopasuror pasi jo vetëm ka humbur të ardhurat e tij në kuadër të pagës, por edhe është cënuar në personalitetin e tij si pasojë e sjelljes diskriminuese. Në interpretim të nenit 625 të K.Civil dhe qëndrimit të mbajtur ndër vite nga gjykata e lartë dëmi moral i referohet dhimbjes shpirtërore, gjëndjes së ankthit dhe turbullimit shpirtëror si rezultat i trajtimit diskriminues të bërë nga i padituri. Për sa i përket dëmit ekzistencial, ai ka të bëjë me përkeqësimin e cilësisë së jetës nga trajtimi diskriminues që i është bërë paditësin në punësim në raport me personat e tjerë. Gjithashtu dëmin pasuror po ashtu është i vërtetuar pasi paditësi nuk ka mundur të realizojë përfitimin e pagës, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës dhe i trajtimit të tij diskriminues në punësim. Gjithashtu ai nuk ka mundur të rivendosë të drejtën e tij të njohur nga komisioneri publike që në vitin 2017 për tu ripunësuar pranë palës së paditur. Ekzistojnë të gjitha kushtet që do të ligjëronin pagesën e dëmit pasuror dhe jo pasuror në të gjitha komponentet e tij sipas nenit 625 dhe 641 të K.Civil, duke u dëmshpërblyer paditësi në vlerën maksimale

	prej	4877	447
--	------	------	-----

lekë.....

4. Duke qënë se padia është pranuar në pothuajse të gjitha kërkimet e saj, atëherë vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet edhe për pjesën e shpenzimeve gjyqsore në pikën 5 të dispozitivit, pasi gjykata e shkallës së parë ia ka ngarkuar ato të paditurit vetëm për pjesën e pranuar të padisë, pa bërë asnjë përcaktim se sa është kjo pjesë e pranuar e padisë në raport me padinë në tërësi. Në bazë të nenit 106 të K.Pr.Civile gjykata e Apelit cmon se shpenzimet gjyqsore të përlogaritura në vendimin e gjykatës së shkallës së parë në masën gjithsej 239 489 lekë i ngarkohen të paditurit pasi padia është pranuar në tërësinë e saj dhe i padituri me sjelljen e tij si në largimin nga puna të paditësit e në refuzimin për marrjen në punë të paditësit pas vendimit të komisionerit është bërë shkak për ngritjen e padisë.

Perderisa kjo çështje është rregjistruar në gjykatën e Apelit pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.38/2017, gjykata e Apelit cmon se në bazë të nenit 510 e vijues të K.Pr.Civile duhet të lëshojë urdhërin e ekzekutimit për këtë vendim me qëllim që ai të ekzekutohet nga zyra e përmbarimit, pasi kanë ndryshuar nga gjykata e Apelit disa disponime të zgjidhjes së çështjes në raport me vendimin e marrë nga gjykata e shkallës së parë.

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata e Apelit Vlore bazuar në nenin 466/a,b të K. Pr. Civile

### **VENDOSI**

- Lënien në fuqi të vendimit nr.62-2018-2188 (573) dt.25.04.2018 të Gjykatës së Rrethit gjyqsor Fier me këtë ndryshim në pikën 4 dhe 5 të vendimit si më poshtë;
- Detyrimin e të paditurit Albpetrol Sh.A. Patos ti paguajë paditësit [REDAKTUAR] shumën e vlerës së dëmit pasuror dhe jopasuror në masën 4 877 447 (katërmilion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë” lekë.
- Shpenzimet gjyqsore i ngarkohen të paditurit.
- Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për këtë vendim duke u ngarkuar zyra e përmbarimit me ekzekutimin e tij.

U shpall në Vlorë më 26.02.2020

**ANETAR**  
Petrit Aliaj

**ANETAR**  
Skënder Damini

**KRYESUESE**  
Margarita BUHALI  
Kunder pjeserisht